



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo
Prosecutorial Council

KPK/nr. 1056/2025
Datë: 20 nëntor 2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, nenit 22 (par.5) të Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 32 (par.1, nënpar.1.2) të Ligjit nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenit 25 (par.1 dhe 2) të Rregullores nr.07/2024 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, nenit 12 dhe neni 37/A të Ligjit nr.08/L-249 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 6 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe nenit 29 dhe 31 (par.4) të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në Takimin e mbajtur më datë 20 nëntor 2025, mori:

V E N D I M

1. Z. Besim Kelmendi shkarkohet nga pozita e ushtruesit të detyrës së Kryeprokuror të Shtetit të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi nga data 21 nëntor 2025.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në Takimin e 278-të mbajtur më datë 20 nëntor 2025, ka propozuar shkarkimin e z.Besim Kelmendi nga pozita e ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me arsyetimi se nga zhvillimet e fundit përkitazi me zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit, ka shprehur publikisht qëndrim të njëanshëm, përfshirë deklaratimet e tij në takimet e Këshillit si dhe në pronocimet publike për medie.

Këshilli konsideron se ky qëndrim i njëanshëm dhe pozicionim i U.D. të Kryeprokurorit të Shtetit, denigron pozitën e tij dhe cenon besimin e sistemit prokurorial dhe të publikut, për qëndrim të paanshëm dhe tërësisht neutral të kësaj pozite të rëndësishme në sistemin prokurorial për procesin zgjedhor.

Me propozimin e kësaj pike, 5 (pesë) nga anëtarët e Këshillit, e lëshuan Takimin në mënyrë të njëanshme dhe të kundërligjshme, pa asnjë arsyetim të bazuar, përfshirë edhe vetë U.D. së Kryeprokurorit të Shtetit, i cili në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi, do të duhej që të largohej dhe të mos merrte pjesë në Takim, pasi që ishte parashtruar kërkesë për shkarkimin e tij në Këshill, me qëllim që të evitohet vendimmarrja e njëanshme dhe konflikti i interesit, meqë vetë ishte subjekt i diskutimit të kësaj pike të propozuar në rend dite, ashtu siç edhe përcaktohet me dispozitat ligjore të nenit 31 (par. 4) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative *“Në rastet e përjashtimit të një anëtarit të organit kolegjial, organi funksionon si i tillë pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar. Kuorumi dhe vendimmarrja llogaritet pa marrë në konsideratë vendin apo votën e anëtarit të përjashtuar”*.

Po ashtu, bazuar edhe në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, në nenin 17, në të cilën është e rregulluar procedura e deklarimit në rast të interesit privat të zyrtarit, ndërsa në nenin 19 të tij, është përcaktuar se zyrtari merr masa për vetëpërjashtimin ose përjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes, diskutimit dhe votimit të çështjes ku i njëjti është subjekt.

Përkundër faktit se ai është paralajmëruar disa herë se duhet që të largohet nga Takimi dhe se qëndrimi i tij në Takim përbën shkelje të këtyre dispozitave ligjore, megjithatë ai ka vazhduar që të qëndroj në takim duke u përpjekur me këmbëngulësi që ta arsyetoj vazhdimin në pozitën e tij aktuale, derisa anëtarët e tjerë filluan që të dalin nga Takimi.

I gjendur në këtë situatë, Këshilli Prokurorioral i Kosovës, pas një pauze të shkurtër, vazhdoi Takimin dhe meqë kishte kuorum të mjaftueshëm, pasi që në sallë kishin mbetur shumica e thjeshtë e anëtarëve të pranishëm, 5 (pesë) anëtarë të Këshillit nga radhët e prokurorëve, përkatësisht gjysma e anëtarëve të zgjedhur të Këshillit + (plus) 1 (një), që i bie 5 (pesë) anëtarë nga gjithsej 9 (nëntë) anëtarët, sipas përcaktimit në nenin 37/A (par.1) i Ligjit për ndryshimin/plotësimin e Ligjit për Këshillin, pas përjashtimit nga trajtimi dhe vendosja e kësaj pike e u.d. të Kryeprokurorit të Shtetit), të cilët në respektim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve në fuqi dhe të rregullave të etikës profesionale, unanimisht vendosën për aprovimin e propozimit për rendin e ditës me kërkesë për shkarkimin e u.d. së Kryeprokurorit të Shtetit, e pastaj unanimisht morën vendim edhe për shkarkimin nga pozita e U.D. të Kryeprokurorit të Shtetit.

Nga të cekurat, me qëllim të ruajtjes së standardit të drejtësisë në këtë institucion të rëndësishëm të sistemit prokurorial dhe me qëllim të garantimit të një sistemi prokurorial efikas, llogaridhënës dhe të pavarur, Këshilli duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, me shumicë votash të anëtarëve të tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ardian Hajdaraj
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë të shfrytëzojë mjetin juridik përkatës në pajtim me ligjin.

T'i dërgohet:

- *Z. Besim Kelmendi, prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;*
- *Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve;*
- *Arkivit të KPK-së.*